

ORKESTRAT SHQIPTARE TË RADIOS

Eno Koço

Informacioni i mëposhtëm është bazuar mbi shkrimet e gazetave, buletinet e Radio Tiranës, *Promemorien* e Haki Bejlerit (prill 1983), të dhënat gojore të personave të ndryshëm deri tek ato më të fundit të Beniamin Guraziut (shkurt 2012). Ky i fundit sot i ka kaluar të 89-at por kujtimet e tij për Orkestrën e parë të Radios janë sikur ngjarjet të kishin ndodhur vetëm një ditë më parë. Midis të tjerave ai më tregonte se rrogën e parë prej 14 napolonash në këtë orkestër e ka marrë në janar të vitit 1945.

Nuk mund të pretendohet që të dhënat që shtjellohen këtu të jenë gjithëpërfshirëse, kështu që sugjerimet dhe korrigjimet e shumëpritura do të ndihmonin për të krijuar një historik sa më të plotë e të saktë lidhur me zhvillimin e orkestrës simfonike në Shqipëri, për të vijuar deri në riorganizimin e asaj që do të emërtohej në dhjetor të vitit 1945 si *Orkestra e Radios* dhe për të mbërritur në formimin e Orkestrës së Radios më 1962 e më vonë asaj të Radiotelevizionit (OSeRTSH).

~ ~ ~

Në vitin 1938, jashtë Tiranës, në Laprakë, u instalua një radio-stacion shtetëror, me një studio të vendosur në ndërtesën e Bashkisë së Tiranës. Stacioni që u përrua nga mbreti Zog më 28 nëntor po të atij viti, transmetonte lajme, biseda të shkurtra mbi problemet dhe aktivitetet publike, si dhe muzikë. Në të njëjtën ditë të inaugurimit, krahas transmetimeve të tjera muzikore, u dhanë dy programe që portretizonin këngëtarët lirikë e viteve 1930.

Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore (1942) u ngrit në Tiranë një orkestër e plotë simfonike, *Orkestra e Forcave të Armatosura*, pjesëtarët e së cilës ishin kryesisht ushtarë e oficerë italianë të mobilizuar, të cilët qenë grupuar këtu si sektor i ushtrisë italiane, por jashtë frontit të luftës (duket ishte menduar që jeta e tyre, por dhe ajo artistike, do mund të ishte më se e sigurt në Shqipëri dhe vërtetë ashtu ndodhi).

Pjesëmarrja e shqiptarëve në këtë orkestër ishte shumë e kufizuar; midis tyre mund të përmenden Osman Banushi dhe Nazmi Maloku. Orkestra, e cila e vazhdoi veprimtarinë edhe gjatë pushtimit gjerman, jepte koncerte në Shtëpinë e Oficerëve (sot Ministria e Kulturës). Repertori i saj përfshinte vepra klasike, por edhe ndonjë vepër të re shqiptare siç ishte *Rapsodia për Orkestër* e Kristo Konos. Në Radio jepeshin edhe koncerte me muzikë dhome e koncerte të formacioneve më të vogla orkestrale. Të gjithë këto koncerte transmetoheshin direkt nga Radio Tirana. Në një gazetë të kohës, 14 korrik 1943, shkruhej se Radio Tirana kishte transmetuar ‘rreth njëzetë koncerte të mëdhenj simfonikë nga më të mirët, duke përmbledhur copa muzike klasike nga më të mirat, copa autorësh klasikë të kohës së kaluar

... ndër të cilat pesë simfonitë më të njohura të Beethoven-it.’

Gjatë luftës në Radio u krijua një sektor i veçantë për muzikën, shef i të cilit ishte Mihal Ciko dhe pjesëtar i këtij sektori Tonin Guraziu e ndonjë tjetër. Cikoja drejtonte edhe korin e burrave në Radio. Kur sapo kishte përfunduar lufta, në dhjetor të vitit 1944, Radio Tirana mendoi të krijojë një Orkestër të sajën. Fillimisht u quajt thjesht, *Orkestra e Radios*. Ajo pjesë e orkestrantëve italianë që mbetën në Shqipëri edhe pas Luftës u përfshinë në të. Në krye të Orkestrës së Radios do të ishte kapiten Umberto Rampi, muzikant me eksperiencë, i cili kryente detyrën kryesisht të dirigjentit, por edhe të violinistit. Të tjerë instrumentistë italianë përbërës të orkestrës ishin violisti Eusebio, violonçelistët Caletti dhe Baldovino, timpanisti Monti, pianisti Ettore (që qëndroi në Shqipëri deri më 1948) e ndonjë tjetër.

Do qëndroj pak në historikun dhe përbërjen e kësaj orkestre për vetë faktin se pak njihet veprimtaria e saj.

Për plotësimin Orkestrës së Radios me përmasa mjaft modeste u bë e nevojshme të mblidhej elementi shqiptar, njerëz që kishin mësuar violinë rregullisht në Normalen e Elbasanit (edhe nën mësimdhënien e Baki Kongolit) apo Gjimnazin e Tiranës që në kohën e Monarkisë e më pas. Ndër ta mund të përmenden violinistët Sofokli Papparisto, Genc Bogdo, Nikolla Zoraqi, Beniamin Guraziu, Haki Bejleri (që u bë edhe folës në Radio), Ali Kruda (më vonë Sofokli Çarçani dhe Islam Petrela), violistët Nikush Guralumi e Nazmi Maloku, violonçelisti Ymer Skënderi. Për veglat e frymës, i vetmi burim i kompletimit të orkestrës ishte Banda Ushtarake e Tiranës apo ish-Banda Mbretërore. Përbërja e orkestrës ishte afërsisht kjo: 10 violina (të para dhe të dyta) ku koncert-maestri ishte italian; dy viola (njëri italian), dy a tri violonçela (dy italianë), dy kontrabasë, njëri italian dhe tjetri që quhej Schwab, ishte çek, me qëndrim në Shqipëri, i cili më parë kish punuar në Pallatin Mbretëror e më pas në Bandën Ushtarake Shqiptare (Llazar Morcka ishte nga ata që mësoi kontrabas me Schwab-in). Ndër instrumentistët e frymës, vetëm klarinetisti i parë ishte italian. Për një farë kohe orkestra nuk kishte as oboe e as fagot, instrumente këto që u mësuan më vonë në mënyrë autodidakte nga Nazmi Maloku dhe Jovan Stefani. Ndërkaq, partet e veglave të munguara të frymës zëvendësoheshin me harmonium nga Valeria Drenova (më vonë edhe Nina Simoni). Instrumentistët frymorë shqiptarë që hap pas hapi iu atashuan Orkestrës së Radios qenë Hamdi Suvaria (klarinetë), Vesel Pinari (klarinetë), Kiço Popi (timpan), Mahir Karabini (trombë), Rabini (flaut) e të tjerë që do të duhet të njihen emrat e tyre.

Orkestra e Radios nuk ishte definitive, por ishte caktuar një pagesë mujore, e cila ishte fikse (afërsisht sa një gjysmë rroge). Punohej çdo ditë nga ora 11.00 deri në 13.00 (më vonë 10 deri 13). Orkestra jepte koncert një herë në javë me muzikë orkestrale në mikrofon, direkt, çdo të premte nga ora 20.30 deri 21. Nga të dy sallat (dhomat e mëdha), ajo majtas shërbente për orkestrën, ndërsa djathtas për lajmet. Brenda kësaj orkestre, ose më mirë elementët më të mirë të saj, kishin formuar edhe një formacion të vogël më të manovrueshëm (prej rreth 15

vetësh) që jepnin edhe një program tjetër në mikrofon, në një ditë tjetër të javës. Orkestra kishte dhe kuartetin e saj (Kuarteti i Tiranës) i përbërë nga U. Rampi, M. Krantja, E. Eusebio dhe W. Caletti, të cilët bashkë me pianistin G. Fiori luanin, midis të tjerash, edhe kuintetin e Boccherini-t (Re–mazor) e të Brahms-it (Fa–minor).

Repertori i Orkestrës ishte kryesisht i huaj pasi ato parte orkestrale disponoheshin. Dominonte repertori klasik (fantazi operistike orkestrale) dhe ai i muzikës së lehtë. Pjesë shqiptare pothuajse nuk kishte fare. Me që nuk ishin orkestruar pjesët tona, shpesh këngëtarët që këndonin me këtë orkestër si Tefta, Maria, Kristaq Antoniu etj., këngët shqiptare i këndonin me piano ndërsa orkestra i shoqëronte këta vetëm në ariet, duetet ose triot e operave.

Në pranverën e vitit 1946, Rampi u dërgua në Itali nga qeveria shqiptare me porosi që të mbledhte një numër orkestrantësh italianë dhe t'i sillte në Shqipëri për të formuar një orkestër më të madhe. Ndodhi një 'incident' politik dhe u fol se qeveria e anuloi urdhrin dhe në fakt Rampi nuk u kthye më. Në korrik të vitit 1946 të gjithë italianët që ende kishin mbetur në orkestër u larguan nga Shqipëria; Caletti u largua fillimisht për në Milano e më pas në ShBA. Pas largimit të Rampit lindi problemi i dirigjentit të orkestrës. Për një farë kohe (ndoshta disa muaj) orkestrën e drejtoi pianisti italian Giovanni Fiori, i cili aso kohe luante në orkestrinën e Hotel Dajtit. Ishte pikërisht kjo periudhë kur jugosllavët ishin të interesuar të depërtonin në Shqipëri edhe nëpërmjet Orkestrës së Radios. Kështu, jugosllavët prematuan të sillnin orkestrantë, por që në fakt u kufizuan me dërgimin e një klarinetisti (Pomikalo), një trombonisti, një violisti (Prof. Miranov) dhe një violonçelisti (Fuçkar). Mbas tyre erdhi Adamiç që luante në trombë dhe që ishte pianist dhe dirigjent i zoti, megjithëse nuk e drejtoi ndonjëherë Orkestrën e Radios.

Pas largimit të italianëve të cilët qenë baza kualitative e Orkestrës së Radios, ishte Mustafa Krantja që, me ato njohuri që kishte, u ofrua të drejtojë orkestrën për një farë kohe deri sa më 1947, së bashku me Ymer Skënderin dhe Genc Bogdon, u dërguan për të studiuar fillimisht në Zagreb e më pas në Pragë. Vendin e Krantjes në krye të Orkestrës së Radios e zuri Osman Banushi, i cili e drejtoi atë deri në mes të vitit 1950. Me raste të rralla e drejtonte këtë orkestër edhe Baki Kongoli, i cili në vitet e ardhshme do të bënte përpjekje të shumta për t'u nxjerrë muzikantëve shqiptarë bursa studimi për në konservatoret e vendeve të Lindjes. Po në këtë vit, më 3 prill, u bë koncerti inaugural i Filharmonisë Shqiptare që ishte bashkim i Orkestrës së Radios, Korit të Përgjithshëm të Shtetit, Trupës së Valleve (Baletit) dhe i një numri këngëtarësh lirikë. Shfaqja e parë e madhe e këtij institucioni ishte baleti *Shatrivani i Bahçisarajt* i Boris Asafjevit. Kështu, Orkestra e Radio Tiranës kaloi e gjitha në Filharmoninë dhe u quajt Orkestra e Filharmonisë deri më në nëntor të vitit 1953 kur u formua Teatri i Operës dhe Baletit. Muzikantët e Filharmonisë u plotësuan edhe me të tjerë të liruar nga ushtria posaçërisht për t'iu bashkuar këtij institucioni. I porsa kthyer nga Praga, në krye të

këtyre institucioneve qëndroi dirigjenti i parë shqiptar i tyre, Mustafa Krantja. Pas studimeve në Itali, ky dirigjent diti të gërshetojë në qenien e tij vizionare eksperiencën që kishte përfutur nga muzikantët italianë të Orkestrës së parë të Radios me parimet dhe praktikën çeke të dirigjimit, për t'ia përshtatur këto eksperiencia realitetit vendas.

~ ~ ~

Kështu, Orkestra modeste e Radios e krijuar më 1944 u riorganizua apo riformua përsëri në gjysmën e parë të vitit 1962 Orkestra Simfonike e Radios u riorganizua përsëri në gjysmën e parë të vitit 1962 për të dhënë koncertin e saj të parë në 25 gusht të po këtij viti. Pjesëtarët e parë të kësaj orkestre të porsa formuar ishin muzikantë që kryenin veprimtari jo orkestrale, nxënës e studentë, si dhe studentët të cilët kishin ndërprerë studimet e tyre në konservatorë të ndryshëm të Evropës Lindore. Shumë shpejt Orkestra e porsa riformuar e Radios u shtua me elementë që vinin nga Konservatori i porsaformuar i Tiranës. Ajo numëron sot 56 muzikantë dhe është formacioni më i rëndësishëm orkestral në Shqipëri. Janë një radhë dirigjentësh që kanë qenë në krye të kësaj orkestre duke nisur nga Mustafa Krantja, Simon Gjoni, Ferdinand Deda, Ermir Krantja, Eno Koço, Jetmir Barbullushi dhe së fundi Oleg Arapi. Orkestra plotëson pjesën më të rëndësishme të veprimtarive koncertore të kryeqytetit, e drejtuar nga dirigjentë shqiptarë e ndërkombëtarë si dhe inkurajon pjesëmarrjen e solistëve vendas e të huaj. Orkestra Simfonike e Radiotelevizionit Shqiptar (OSERTSH), emërtim që e mori pas bashkimit të të dy institucioneve, Radios dhe Televizionit, veç koncerteve të rregullta me repertorin bazë simfonik, bën edhe koncerte me muzikë të lehtë duke organizuar në çdo fund-viti veprimtarinë më të rëndësishme të saj në këtë fushë, Festivalin e Këngës në Radiotelevizion. Megjithatë, duhet theksuar se veprimtaria e rregullt e saj është kalendari koncertor simfonik vjetor, i cili shpallet dy herë në vit. Në stabilizimin e këtij kalendari kontribut të vlefshëm ka dhënë udhëheqësi artistik më i ri i kësaj orkestre, David Tukiqi.

Një nga përparësitë e saj kryesore, veçanërisht deri në vitin 1991, ka qenë regjistrimi i veprave simfonike, vokale dhe instrumentale të kompozitorëve shqiptarë. Simfonitë, poemat simfonike, rapsoditë, koncertet instrumentale, fragmentet vokale operistikë, fragmentet e muzikës së filmave, ishin pjesa dominuese e repertorit kombëtar të Orkestrës. U gjallëruan veprat e kompozitorëve shqiptarë të para-Luftës që të gjitha ishin të panjohura për publikun shqiptar dhe, kësaj, u zgjerua gama kohore e krijimtarisë së muzikës savante shqiptare. U krijua një fond i konsiderueshëm arkivor mbi të cilin mbështeten jo vetëm programet radiofonike por që shërben si e vetmja bazë për studimin e muzikës savante shqiptare. Studioja e regjistrimit pranë orkestrës bashkë me teknikët dhe inxhinierët e saj të zërit kanë krijuar ato parametra që identifikojnë tingëllimin e repertorit simfonik kombëtar, muzikën e filmave dhe atë të lehtë. Me regjistrimet e saj kryesisht në shirita magnetikë por së fundi të konvertuara edhe në CD e DVD, OSERTSH ka fiksuar zërin e këngëtarëve operistikë si Inva Mula apo instrumentistëve si Tedi Papavrami, të cilët njihen për reputacionin e tyre të

spikatur ndërkombëtar. Por ngarkesën e repertorit solistik të Orkestrës e kanë mbajtur padyshim instrumentistët e vokalistët tanë duke nisur që nga i pari solist i saj, violinisti Ibrahim Madhi deri tek më të rinjtë virtuozë. Numri i tyre është jo i vogël, prandaj lënia pa dashje e ndonjë emri të papërmendur nuk do t'i bënte nder kësaj ekspozite mbi Orkestrën. E njëjta gjë edhe për renditjen e kompozitorëve më në zë shqiptarë.

Repertori ndërkombëtar klasik, romantik a bashkëkohor zë sot vendin më të rëndësishëm në veprimtarinë koncertore të Orkestrës. Nivelin e Orkestrës e ka ngritur nga viti në vit jo vetëm ekzekutimi i shumtë e i larmishëm i këtij repertori por edhe eksperiencia dhe mjeshtëria e dirigjentëve të huaj të cilët shpalosin vizionin e tyre mbi stilet ekzekutive, duke sugjeruar kërkesa konkrete për një bashkëtingëllim sa më kompakt, harmonioz e bashkëkohor të orkestrës. Emra të tillë si Hikmet Şimşek, Doron Solomon, Massimo Bernard, Leonid Nikollajev e shumë të tjerë, kanë lënë ndikim të ndjeshëm në aftësitë ekzekutive të Orkestrës dhe kanë bërë që kjo të ngrejë nivelin e saj ekzekutive e të njehet në standard me shumë nga orkestrat simotra të Europës. Turnetë koncertale jashtë Shqipërisë si ato në Angli, Itali, Turqi, apo vendet ballkanike si Greqi, Maqedoni, Malin e Zi e Kosovë, kanë zgjeruar njohjen e saj, duke bërë të njohur në botë vlerat e artist ekzekutive muzikor shqiptar. Nga gjiri i Orkestrës kanë treguar aftësitë e tyre në skenë si solistë disa nga muzikantët e saj dhe përsëri nga kjo Orkestër kryejnë veprimtari formacione të muzikës së dhomës ku nga më të shquarit është kuarteti më jetëgjatë dhe më cilësor i vendit, i frymëzuar dhe i orientuar muzikalisht nga violonçelisti i mirënjohur Aristidh Prosi. Një pjesë e mirë e muzikantëve të kualifikuar të kësaj Orkestre u transmetojnë njohuritë e tyre profesionale brezave të ardhshëm që studiojnë në Universitetin e Arteve të Tiranës. Rol të rëndësishëm padyshim kanë luajtur udhëheqësit artistikë në vite të Orkestrës ku ndër më jetëgjatët në këtë funksion mund të përmenden Gjon Simoni e Zhani Ciko. Koncertet e përjavshme që jepen në TV nga kjo Orkestër, të marra direkt nga ekzekutimi i gjallë në skenë, plotësojnë nevojat e artdashësve për këtë lloj muzike. Regjistrimet radiofonike e televizive të Orkestrës janë transmetuar edhe nga kanale të huaja mediatike, ku për t'u veçuar është stacioni RAI. Kështu, Orkestra ka fituar njohje jo vetëm mbarëkombëtare por edhe përtej kufijve shtetërorë.

Po i referohem vetëm kritikës muzikore botuar në *Kentish Gazette* më 2008 shkruar nga Elaine Godden dhe kjo do të fliste më shumë se çdo konsideratë e imja lidhur me koncertin që OSeRTSH të dhënë në Canterbury. Ja një fragment: 'Në simfoninë e Tetë të Dvorzhakut orkestra transmetoi ndjeshmërinë e saj të larmishme e të pasur: meloditë e ndryshme të kohës së parë, kornot tërë shkëlqim dhe fanfara finale e trombave, pasazhet e pasura të violonçelave, interludi lirik dhe forca dramatike e masave të fundit, të gjitha këto u luajtën shkëlqyeshëm për të përfunduar muzikën e mrekullueshme të kësaj mbrëmjeje'.

~ ~ ~

Duke e përmbledhur këtë historik të shkurtër mund të thuhet se institucioni i ekzekutimit

orkestral në Shqipëri nisi me ndërtimin e një orkestre me elementë kryesisht të huaj gjatë Luftës së Dytë Botërore, për ta kthyer këtë institucion në *Orkestrën e Radios* më 1945, për ta shndërruar më pas në orkestër e trupë filharmonike më 1950, për t'u shndërruar përsëri kjo trupë në *Teatrin e Operës dhe Baletit* më 1953 dhe për t'u veçuar nga kjo e fundit e për t'u rikrijuar si orkestër e pavarur, *Orkestra Simfonike e Radios*, më 1962. Me rritjen dhe fuqizimin e Radiotelevizionit, orkestra mori peshën e asaj që quhet sot, Orkestra Simfonike e Radiotelevizionit Publik Shqiptar (OSerTPSH).